

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6551
E shtunë, 5 mars 2022
çmimi 0.40

Gjendja e sigurisë në Kosovë është stabile

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I KUVENDIT TË MAQEDONISË SË VERIUT, TALAT XHAFERI,
PO QËNDRON PËR VIZITË ZYRTARE DYDITORE NË KOSOVË

FAQE 4-5

KOSOVA DHE MAQEDONIA VLERËSOJNË SE DUHET THELLUAR AGJENDA E PËRBASHKËT E INTEGRIMIT



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takim homologun nga Maqedonia e Veriut, Talat Xhaferi, me të cilin ka diskutuar për një mori çështjesh me interes të përbashkët, përfshirë edhe zhvillimet aktuale në rajon dhe më gjerë. Të dy homologët ndanë pikëpamje të përbashkëta lidhur me nevojën e thellimit të bashkëpunimit bilateral dhe avancimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve në funksion të realizimit të agjendave të përbashkëta integruese

AKTUALE



THIRRJE NGA STUDIUESI AREF PËR
LIDERËT SHQIPTARË: SHPËTOJINI
SHQIPTARËT E UKRAINËS! F. 3

MË 24 MARS MBAHET KONFERENCA
E RADHËS NDAJ ISH-DREJTUESVE
TË UÇK-së F. 5

ABELARD TAHIRI FITON NDAJ
ALBULENA HAXHIUT PËR RASTIN E
NOTERËVE F. 5

EKONOMI



'PANIKU' PËR MIELL F. 7

ATK-ja RRIIT TË HYRAT
PËR 30 MILIONË EURO
PËR VETËM DY MUAJ F. 6

SPORT



GJENERATA E ARTË E PËRKRAH
ADEMIN EDHE PËR NJË MANDAT

F. 10



SA I RREZIKSHËM ISHTË SULMI I RUSISË NË CENTRALIN BËRTHAMOR?

Zyrtarët ukrainas thonë se forcat ruse morën nën kontroll centralin bërthamor më të madh në Evropë, Zaporizhzhia, pranë qytetit ukrainas Enerhodar, pasi e bombarduan atë dhe një objekt banesor i cili u përfshi në flakë

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sa i rrezikshëm ishte sulmi i Ruisë në centralin bërthamor?

Zyrtarët ukrainas thonë se forcat ruse morën nën kontroll centralin bërthamor më të madh në Evropë, Zaporizhia, pranë qytetit ukrainas Enerhodar, pasi e bombarduan atë dhe një objekt banesor u përfshi nga flakët

KIEV, 4 MARS - Termocentrali më i madh bërthamor në Evropë u godit nga bombardimet ruse herët të premtën, duke shkaktuar zjarr dhe duke rritur frikën për një fatkeqësi që mund ta prekë të gjithë Evropën qendrore për dekada të tëra, si shkrirja në centralin e Çernobilit më 1986. Shqetësimet u zbehën pasi autoritetet ukrainase njoftuan se zjarri është shuar dhe ndonjëse kishte dëmtime në ndarjen e reaktorit, siguria e njësisë nuk u ndikua. Por, edhe pse centrali bërthamor i Zaporizhjas ka një dizajn të ndryshëm nga ai i Çernobilit dhe është i mbrojtur nga zjarri, ekspertët e sigurisë

Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (IAEA), Rafael Mariano Grossi, konfirmoi se asnjë material radioaktiv nuk është liruar nga zjarri në centralin më të madh bërthamor në Evropë. Pasoja e kësaj, tha presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy, do të ishte shumë e përhapur dhe e tmerrshme. “Nëse ka një shpërthim, ky është fundi për të gjithë. Fundi për Evropën. Evakuimi i Evropës”, tha ai në një fjalim emocionues në mes të natës, duke u bërë thirrje vendeve të bëjnë presion mbi udhëheqjen ruse për t’u dhënë fund luftimeve pranë uzinës. “Vetëm veprimi urgjent i Evropës mund t’i ndalojë



Këshilli i OKB-së miraton rezolutën për dënimin e Ruisë

Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka mbështetur me shumicë dërrmuese një rezolutë që dënon pushtimin rus të Ukrainës dhe ngritjen e një komisioni hetimor për ta hetuar atë për krime lufte. Vetëm një shtet, Eritrea, në

Afrikën Lindore, votoi kundër rezolutës, ndërsa 32 votuan për dhe 13 abstenuan. Përpara votimit, ambasadori i Ukrainës tha: “Është detyra jonë e përbashkët të sigurojmë llogaridhënie duke mandatuar dokumentacionin dhe verifikimin e krimeve të

Ruisë dhe identifikimin e atyre që janë përgjegjës”. Rusia ka mohuar të ketë shënjestruar njerëzit në Ukrainë, pavarësisht prej pamjeve të përhapura të ndërtesave të shkatërruara të banimit dhe vdekjen e 2 000 civilëve.



bërthamore dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike paralajmërojnë se lufta brenda dhe rreth këtyre objekteve paraqet rreziqe ekstreme. Një shqetësim i madh, i ngritur nga Rregullatori Shtetëror Bërthamor i Ukrainës, është se nëse luftimet ndërpresin furnizimin me energji të centralit bërthamor, ai do të detyrohet të përdorë gjeneratorë me naftë më pak të besueshëm, për të siguruar energji emergjente për sistemet operative të ftohjes. Një dështim i këtyre sistemeve mund të çojë në një fatkeqësi të ngjashme me atë të uzinës japoneze të Fukushima, kur një tërmet masiv dhe cunami në vitin 2011 shkatërruan sistemet e ftohjes, duke shkaktuar shkrirje në tre reaktorë. Drejtori i Përgjithshëm i

trupat ruse. Mos lejoni vdekjen e Evropës nga një katastrofë në një central bërthamor”, tha ai. Presidenti rus Vladimir Putin ka paralajmëruar të premtën ata që kundërshtojnë veprimet e Ruisë në Ukrainë, që të mos “ekzagjerojnë situatën” duke vendosur më shumë sanksione ndaj shtetit të tij.

Presidenti rus ka folur në një takim qeveritar që është transmetuar në kanalën shtetëror “Rossiya 24”. “Ne nuk kemi synime të këqija kundër fqinjëve tanë”, ka pretenduar Putin. Ai ka thënë se qeveria e tij “nuk sheh nevojë” që fqinjët të marrin veprime shtesë, të cilat do t’i “bëjnë marrëdhëniet tona edhe më të këqija”. “Mendoj që secili duhet të mendojë si t’i normalizojmë marrëdhëniet, të bashkëpunojmë normalisht dhe të zhvillojmë marrëdhënie normalisht”, ka shtuar ai.



Kjo deklaratë vjen pasi ministrat e Jashtëm të Perëndimit janë mbledhur në Bruksel për të shqyrtuar mundësinë si ta rritin presionin ndaj Ruisë. Putini, po ashtu, ka përsëritur pretendimet paraprake se të gjitha veprimet e marra nga ushtria ruse janë bërë “ekskluzivisht si përgjigje ndaj disa veprimeve jomiqësore kundër Federatës Ruse”. Sulmi i Moskës ndaj Ukrainës ka nisur në orët e para të 24 shkurtit. Putini ka urdhëruar “operacion special” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Ai ka thënë të enjten, më 3 mars, se “operacioni special ushtarak” në Ukrainë është duke shkuar sipas planit dhe i ka konsideruar ushtarët rusë si heronj. Komentet televizive të Putinit kanë qenë në kundërshtim me deklaratat e qeverive të Perëndimit dhe agjencive të inteligjencës se fushata ushtarake e Putinit po përballet me probleme logjistike, gabime taktike dhe rezistencë më të madhe sesa

është pritur nga Ukraina. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

Ushtria ukrainase: Rusia ka humbur 9 mijë trupa deri më tani, qindra tanke dhe 33 avionë

Ushtria ukrainase ka bërë bilancet e fundit të humbjeve të ushtrisë ruse, të cilat kanë marrë përmasa të mëdha. Në ditën e nëntë të luftimit, Ukraina thotë se rreth 9 166 trupa ruse janë vrarë në konflikt. Kjo shifër u konfirmua edhe më herët nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy. Ukraina thotë se humbjet e tjera ruse përfshijnë të paktën 251 tanke, 33 avionë, 37 helikopterë, 404 automjete dhe 105 sisteme artilerie. Këto shifra janë shumë më të larta se ato të cituara nga Moska, e cila thotë se ka humbur 498 trupa deri më tani në konfliktin njëjavor.

Më 24 mars mbahet konferenca e radhës ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Konferenca e njëmbëdhjetë për ecurinë e çështjes në rastin kundër të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është caktuar më 24 mars. Lajmi është bërë me dije me dije në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, ku është thënë se konferenca do të nisë në orën 14:30.

Në konferencën e 22 shkurtit është zhvilluar një debat i ashpër në mes të mbrojtjes së ish-drejtuesve të UÇK-së dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në lidhje me dëshmitarët.

Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, kishte thënë se mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje pa kufizime për intervistimin e dëshmitarëve. Ai pati deklaruar se në situatën aktuale dhe me masat mbrojtëse të propozuara nga prokuroria nuk ka barazi në mes të palëve në procedurë. "Nuk ka barazi të palëve. Flasim për një gjykatë që është e Kosovës dhe dispozitat që duhet të ndiqen. Kjo është shumë e qartë në kuadrin e kësaj gjykate. Procesi gjyqësor kërkon që mbrojtja të përfshihet në të gjithë gamën e shërbimeve. Pra, mbrojtja duhet të sigurojë pa kufizime mbrojtjen e një personi, mbrojtjen e provave dhe përgatitjen për marrjen në pyetje. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë se marrja në pyetje duhet të bëhet pa kufizime, ndërsa ndryshe vepron Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS)", kishte thënë Keohe.

Më tutje, ai kishte thënë se 157 dëshmitarë të ZPS-së kanë masa mbrojtëse. "Dëshmitarët në listën e dëshmitarëve nuk janë dëshmitarë në listën e ZPS-së. Pikë. Janë dëshmitarë që



duhen marrë në pyetje nga të gjitha palët. Kjo është një shtesë paligjshmërie. Kemi 326 dëshmitarë, pothuajse 50 për qind kanë masa mbrojtëse. Pra 157 dëshmitarë nga 326 kanë masa të tilla", kishte deklaruar ai.

Avokati i Thaçit kishte thënë se absurditeti qëndron në faktin se ZPS-ja ka kërkuar masa mbrojtëse edhe për zyrtarë qeveritarë, ndërkombëtarë, si dhe oficerë ushtarakë. "Janë nën masat mbrojtëse të ZPS-së. Kam lexuar dëshminë e një dëshmitari që përfaqësohej nga një avokat i zoti në Britani. Pra, nga të gjithë këta persona, ZPS-ja po dëshiron ta përjashtojë mbrojtjen që të bëjë intervistimin e tyre. ZPS-ja thotë se kërkon që ta shmangë ritraumatizimin e viktimave. A po e thotë me seriozitet ZPS-ja se edhe gjeneralëve duhet t'u mbrojtë anën psikologjike?

Sigurisht që jo", pati deklaruar avokati i Thaçit. Ndërsa avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, kishte hedhur akuza të rënda ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Gjykatën Speciale në lidhje me protokollin e propozuar nga kjo zyrë për kontaktet me dëshmitarët.

Emmersoni pati deklaruar se pretendimet e ZPS-së për ndërhyrje të mundshme të mbrojtjes të dëshmitarët janë qesharake dhe fyese. "Janë komente fyese. Nuk përputhen fare me rregullat dhe dua ta trajtoj sepse është koment serioz. Ju duhet ta shikoni mënyrën se si paraqitet çështja te prezumimi i pafajësisë. Çështja kryesore është proporcionaliteti i kësaj që propozohet. Prokurori tha që nuk e dinte nëse e kishte të drejtë t'i përfaqësonte viktimat. Ai nuk e ka këtë të drejtë. Siç thotë prokuroria se për çfarë është ky

protokoll dhe cila është metodologjia? Prokuroria thotë se do të shmangë ritraumatizimin e dëshmitarëve dhe ta ruajë integritetin e tyre fizik", ka thënë ai.

Ai pati kërkuar që të përjashtohet nga procesi gjyqësor çdo person i cili nuk është viktimë. Më tutje, avokati i Veselit kishte thënë se ZPS-ja ka orkestruar takime me ambasadorët evropianë për çështjen e të akuzuarve dhe, sipas tij, kjo është diçka shokuese. "Sipas tyre, ne nuk duhet ta kemi besën dhe ne jemi njerëz jo të duhur. Çështjet e ngritura nga mbrojtja kundër prokurorisë lidhen me deklarata jo të sakta lidhur me kohëzgjatjen e procedurave për periudhën paraprake dhe shanset e lirimit paraprak. Prokuroria e ka keqorientuar gjykatën në shumë mënyra. Prokuroria ka orkestruar takimin e ambasadorëve evropianë në

lidhje me të akuzuarit. Kemi pasur zhvillime të tmerrshme sa i përket sjelljes së prokurorisë. Është një shok dhe tronditje se si prokuroria është lejuar të silltet në këtë mënyrë. Të thuash se unë jam një person që do të kryeja krim në përgatitjen e mbrojtjes është e turpshme. Ky është një shembull se si prokuroria ka humbur çdo arsye dhe logjikë dhe është e dëshpëruar", ka thënë Emmersoni.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi gjenden në paraburgim në Hagë nga 5 nëntori i vitit 2020. Qysh në fillim të këtij procesi gjyqësor ata janë deklaruar të pafajshëm nga të gjitha pikat e aktakuzës. Përpos Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, në Gjykatën Speciale gjenden edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala.

Thirrje nga studiuesi Aref për liderët shqiptarë: Shpëtojini shqiptarët e Ukrainës!



Nga: Mathieu Aref Canameti (Arif Mati)

-Thirrje qeverive shqiptare të Tiranës dhe të Prishtinës

Meqenëse ka shumë ukrainas me origjinë shqiptare në ODESA dhe në Ukrainë, i kërkoj solemnisht qeverive shqiptare të shqetësohen për fatin e tyre dhe të bëjnë ç'është e nevojshme për t'u ardhur në ndihmë dhe nëse është e nevojshme t'i mirëpresin në atdheun shqiptar të origjinës së tyre (përkohësisht ose

përfundimisht). Historia po dëshmon karakterin agresiv, verbërisht shovinist, doktrinar dhe fetar të rrezikshëm, të papërgjegjshëm dhe ekstremistë të disa sllavëve ortodoksë, duke përfshirë sidomos presidentin aktual Putin (Kosova është një shembull flagrant i këtij agresiviteti). Për sa kohë që

Putini është në pushtet, paqja botërore do të rrezikohet. Nëse veproni në favor të këtij minoriteti me origjinë shqiptare, nuk është vetëm detyra juaj, por një prioritet që vetëm mund t'ju bëjë të rriteni, të krenoheni dhe t'ju lajkasë guximin dhe dinjitetin tuaj dhe i gjithë kombit shqiptar i cili do t'ju jetë mirënjohës. Së fundi, duke

ditur se çfarë po ndodh në skenën ndërkombëtare për shkak të agresionit rus kundër popullit të pavarur, patriot dhe i guximshëm ukrainas, ne nuk mund të qëndrojmë të heshtur përballë një ngjarjeje të tillë dhe detyrës sonë por të qëndrojmë me solidaritet me çdo popull ku pavarësia, dinjiteti dhe integriteti kufitar i të cilët kërcënohen.



KRYETARI I KUVENDIT TË MAQEDONISË SË VERIUT, TALAT XHAFERI, PO QËNDRON PËR VIZITË ZYRTARE DYDITORE NË KOSOVË

Kosova dhe Maqedonia vlerësojnë se duhet thelluar agjenda e përbashkët e integrimit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim homologun nga Maqedonia e Veriut, Talat Xhaferi, me të cilin ka diskutuar për një mori çështjesh me interes të përbashkët, përfshirë edhe zhvillimet aktuale në rajon dhe më gjerë. Të dy homologët ndanë pikëpamje të përbashkëta lidhur me nevojën e thellimit të bashkëpunimit bilateral dhe avancimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve në funksion të realizimit të agjendave të përbashkëta integruese

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim një delegacion parlamentar të Maqedonisë së Veriut të kryesuar nga kryeparlamentari Talat Xhaferi. Në këtë takim u diskutuan një mori çështjesh me interes të përbashkët, përfshirë edhe zhvillimet aktuale në rajon e më gjerë, si dhe mënyrat e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes të dyja vendeve në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Konjufca u shpreh i nderuar të pres në takim kryeparlamentarin Talat Xhaferi, duke e falënderuar për kontributin e tij të veçantë në ndërtimin e marrëdhënieve të mira ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut që, siç tha, mund të konsiderohen më shumë se marrëdhënie miqësie e partneriteti. “Besoj se në Kosovë ndiheni si në shtëpinë tuaj dhe jeni kurdoherë i mirëseardhur”, tha ai. Kreu i Kuvendit një herë vlerësoi rolin pozitiv të Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit të

Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe në rrugën e integrimit evropian, duke shprehur besimin se kjo mbështetje e fqinjit tonë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. “Jemi në një rrugëtim të përbashkët. I gjithë Ballkani Perëndimor duhet të pranohet sa më parë në BE dhe në NATO për të mos lënë hapësira destabilizimi në rajonin tonë”, ka thënë Konjufca. Të dy homologët ndanë pikëpamje të përbashkëta lidhur me nevojën e thellimit të bashkëpunimit bilateral dhe avancimit të mëtejshëm të

marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve në funksion të realizimit të agjendave të përbashkëta integruese. Në konferencën për medie pas takimit, Konjufca ka thënë se relacionet e mira midis dy vendeve diktohen prej vetë natyrës së lidhjes që e kanë të dy popujt me njëri-tjetrin dhe bashkëpunimit shumë të mirë që institucionet e të dyjave vendeve kanë midis tyre. Duke veçuar këtu rolin e parlamenteve, Konjufca përmendi miratimin në të njëjtën kohë nga Kuvendi i Kosovës dhe ai i Maqedonisë së Veriut të rezolutës, përkatësisht deklarates, kundër agresionit rus në Ukrainë, e cila, siç tha ai, po sulmohet padrejtësisht nga Federata ruse, duke shkaktuar shumë humbje të jetëve të civilëve të pafajshëm, duke mos kursyer as fëmijët. “Ne jemi shumë të gëzuar që në të njëjtën kornizë po veprojmë së bashku me Maqedoninë e Veriut për të qenë plotësisht të

përcaktuar për sanksionet për të cilat BE-ja, NATO-ja dhe shtetet më të fuqishme demokratike, në krye me diplomacinë më të fuqishme të botës, ShBA-në, po i vendosin Federatës ruse. Pra, edhe Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut janë në të njëjtën linjë të përcaktimit propeperëndimor, prodemokratik dhe protransatlantik”, ka pohuar Konjufca. Kreu i Kuvendit shtoi se anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO edhe një herë po e sjell në vëmendje rëndësinë e vet, sidomos pas situatës së krijuar në Ukrainë. “Të gjithë ata skeptikë që kishin dilema për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, si dhe të Malit të Zi e të Shqipërisë më herët, sot e kuptojnë se sa i rëndësishëm ishte ky anëtarësim dhe e kuptojnë se edhe Kosova duhet sa më shpejt të bashkohet me këtë familje të ombrellës

Një i vdekur dhe 52 raste me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të premten se nga 1 324 testime, 52 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të premten janë shëruar edhe 154 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 221 932.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 1 464.

Ndërkaq 21 pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë po marrin trajtim në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, 15 të

tjerë të negativizuar, post-Covid-19. Me oksigjeno-terapi janë 23 pacientë, kurse në Mjekim Intensiv po trajtohen 4 pacientë.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 444 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 814 984 doza të vaksinës.

Deri më sot 816 909 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 97 984 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

Abelard Tahiri fiton ndaj Albulena Haxhiut për rastin e noterëve

PRISHTINË, 4 MARS - Ish-ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka fituar betejën gjyqësore ndaj ministres aktuale të Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në lidhje me rastin e noterëve.

Departamenti për Çështje Administrative ka anuluar vendimin e Ministrisë së Drejtësisë (MD), me të cilin ishte anuluar konkursi për noterë pasi që gjykata ka aprovuar padinë e 44 kandidatëve për noterë të ushtruar ndaj këtij vendimi, raporton "Betimi për Drejtësi". Noterët ishin emëruar në periudhën sa ministër ishte Abelard Tahiri. Duke synuar se ky proces ka pasur parregullsi, kishte ngritur padi Ministria e Drejtësisë aktuale në krye me Albulena Haxhiun.

Por, gjykata ka vërtetuar provimin e noterisë me arsyetimin se nuk ka gjetur prova se e paditura, qoftë në procedurë administrative ose edhe para gjykatës, ka vërtetuar se Komisioni për Dhënie e Provimit për Noterinë ka cenuar parimin e ligjshmërisë.



transatlantike të sigurisë, aty ku përfundimisht e ka vendin", ka deklaruar Konjufca.

Duke iu përgjigjur interesimit të gazetarëve, Konjufca ka thënë se nuk duhet përjashtuar kurrë mundësia e agresionit serb mbi Kosovën, duke shtuar se raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë më të këqija se ato në mes të Rusisë dhe Ukrainës. "Federata Ruse e ka njohur Ukrainën, ishte pajtuar me shtetësinë e saj dhe prapë e ka sulmuar. Serbia as nuk e njeh Kosovën. Nga ky kuptim unë mendoj se duhet të kemi kujdes të shtuar me Serbinë. Forcat e Sigurisë së Kosovës duhet ta shtojnë nivelin e të drejtës së tyre për llojin e armatimit. Kosova padyshim duhet ta ketë

edhe nivelin artilerik të ushtrisë së vet dhe natyrisht që të gjitha këto ne do t'i bëjmë në bashkëpunim me NATO-n", ka theksuar Konjufca.

Ndërkaq lidhur me mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se sipas mënyrës që ato janë mbajtur deri tash, pra ilegale dhe në shpërputhje me praktikatat ndërkombëtare, nuk i kontribuojnë stabilitetit të Kosovës. Rrjedhimisht, ai tha sikurse referendumi i Serbisë i cili nuk u lejua të mbahej, edhe zgjedhjet e kanë të njëjtin kuptim dhe ashtu duhet të trajtohen.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së

Veriut, Talat Xhaferi, tha se "ne jemi më shumë se fqinj" dhe se të dy vendet kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme bilaterale, që karakterizohen me respekt të ndërsjellë, dialog të hapur dhe konstruktiv. Ai tha se kjo vizitë është provë konkrete për këtë konstatim, siç ishte edhe mbajtja e mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe asaj të Kosovës në shtator të vitit të kaluar.

Xhaferi e konsideroi tejet të rëndësishme pjesëmarrjen e Kuvendit të Kosovës në një varg institucionesh dhe mekanizmash ndërkombëtarë parlamentarë, në të cilat shtrihet edhe bashkëpunimi midis dy parlamenteve.

Po ashtu, ai ka thënë se Maqedonia e Veriut, si anëtare e plotfuqishme e NATO-s, mbështet aspiratat euroatlantike të Kosovës, duke qenë në dispozicion të ndajë njohuritë dhe përvojat e fituara nga rrugëtimi euroatlantik i saj. "Ne si Maqedoni kemi qëndrim afirmativ sa i përket anëtarësisë së Kosovës në të gjitha nismat dhe forumet multilaterale dhe rajonale dhe do ta vazhdojmë edhe më tej mbështetjen e anëtarësisë së saj në të gjitha organizatat dhe nismat ndërkombëtare, në të cilat jemi anëtar me fuqi votuese", ka deklaruar Xhaferi. Duke folur në lidhje me dialogun ndemjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, Xhaferi ka

thënë se Maqedonia i jep mbështetje të plotë këtij dialogut, i cili duhet të ketë në qendër njohjen reciproke.

Sa i përket agresionit rus mbi Ukrainën, Xhaferi përsëriti qëndrimin se Republika e Maqedonisë e dënon në mënyrën më të ashpër dhe pa rezerva këtë akt të paarsyeshëm, të pandërgjegjshëm dhe të paprovokuar, cili tanimë mori shumë jetë njerëzore dhe i cili, sipas tij, paraqet shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare dhe njëherësh kanosjen më të madhe ndaj sigurisë euroatlantike.

Kryeparlamentari Talat Xhaferi po qëndron për vizitë zyrtare dyditore në Kosovë me ftesë të kryetarit Glauk Konjufca.

Gjatë shkurtit janë shqiptuar 6 858 gjoba në trafik në rajonin e Pejës

Pejë, 4 mars (ER) - Gjatë muajit shkurt nga njësitet dhe stacionet policore në Pejë janë shqiptuar gjithsej 6 858 fletëgjoba për kundërvajtësit të cilët nuk kanë respektuar Ligjin e Komunikacionit

Rrugor. Policia bën apel të mos drejtoni automjetin kur jeni të lodhur apo pa gjumë dhe mos të vozitni nën ndikimin e alkoolit. "Përdorimi i telefonave mobilë gjatë vozitjes

vlerësohet të jetë mjaft i rrezikshëm dhe ndalohet rreptësisht gjatë drejtimit të automjetit. Policia e Kosovës me njësitet e saj po ndërmerr dhe do të ndërmarrë masa rigorozë ligjore ndaj të gjithë

pjesëmarrësve në rrugë që shkelin ligjin e trafikut dhe zero tolerancë do të aplikohet ndaj tyre, me të vetmin qëllim që të kemi sa më pak aksidente", thuhet në njoftimin për medie.



ATK-ja rrit të hyrat për 30 milionë euro për vetëm dy muaj

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 4 MARS - Institucion i Administratës Tatimore të Kosovës, si një ndër më të rëndësishmit për mbushjen e arkës së shtetit të Republikës së Kosovës, ka arritur që për dy muajt e parë të këtij viti të mbledhë 124.9 milionë euro tatime.

Në njoftimin e bërë për medie thuhet se ky trend i performancës së të hyrave ka tejkaluar objektivat e planifikuara për këtë periudhë, duke arritur që të mblidhen 11.8 milionë euro apo 10.4 për qind më shumë. "Gjithashtu në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 është arritur të rriten të hyrat për 30 milionë euro apo 31.6 për qind", thuhet në njoftimin për media.

ATK-ja të gjitha aktivitetet e saj tashmë i ka të koordinuara sipas

planit strategjik për vitin 2022-2026, në të cilin janë të përfshira objektivat; forcimi i mbledhjes së të hyrave dhe zvogëlimi i hendekut tatimor - maksimizimi i të hyrave të mbledhura dhe të pagueshme, sipas ligjeve tatimore të Kosovës; modernizimi i Administratës Tatimore - zbatimi i një sistemi të ri të administrimit të teknologjisë së informacionit, modernizimi i strukturave tona organizative, si dhe ngritja e kapaciteteve të stafit dhe kapaciteteve institucionale për t'iu përgjigjur mjedisit tonë të ri. "Për ta implementuar planin strategjik, ATK-ja do të avancojë një sërë nismash reformuese për të ndërtuar një administratë tatimore moderne dhe efektive. Këto nisma do ta udhëzojnë hartimin e strategjive dhe veprimeve specifike në planet tona vjetore operative dhe strategjike. Andaj,



menaxhmenti i lartë i ATK-së u bënë thirrje të gjithë tatimpaguesve që t'i kryejnë në

kohë obligimet e tyre tatimore, pasi kjo është një ndër shumë mundësitë kur ju mund të

kontribuoni për shtetin tonë", është bërë me dije në njoftimin për medie.

Gjendja e sigurisë në vend është stabile



PRISHTINË, 4 MARS - Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, pas takimit të komisionit me drejtorin e AKI-së, Petrit Ajeti, ka thënë se gjendja e sigurisë në vend është stabile dhe institucionet e sigurisë janë në krye të detyrës.

Musliu pas mbledhjes së komisionit me drejtorin e AKI-së në një konferencë për medie ka kërkuar që të mos krijohet panik pasi vendi nuk kërcënohet drejtpërdrejt nga ndonjë pasiguri. "U informuam në detaje për gjendjen e sigurisë në vend.

Dua t'i siguroj qytetarët e Kosovës se nuk ka vend për panik. Gjendja e sigurisë në vend është stabile, kujdesi i institucioneve të sigurisë, përfshirë AKI-në që është në krye të detyrës, prandaj nuk ka vend për panik", ka deklaruar deputetja Musliu.

Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së ka kërkuar që presidentja edhe kryeministri të dalin dhe të deklarohen për gjendjen e sigurisë në vend pasi te qytetarët është vërejtur panik i shtuar. "Nuk ka vend për panik dhe nuk kërcënohemi drejtpërdrejt nga ndonjë pasiguri", është shprehur Musliu.

Komandanti i FSK-së realizoi vizitë zyrtare në Turqi

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Komandanti i FSK-së, gjeneral Jashari, nga data 27 shkurt 2022 deri më 2 mars realizoi vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë si pjesë e delegacionit shtetëror të prirë nga presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Gjatë vizitës, si pjesë e delegacionit

shtetëror, gjeneral Jashari u takua me krerët më të lartë shtetërorë, duke përfshirë presidentin e Republikës së Turqisë, Rexhep Erdogan, kryetarin e Parlamentit të Turqisë, Mustafa Shentop si dhe shumë udhëheqës të tjerë institucional turqë. Takim i veçantë u realizua me shefin e Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të

Republikës së Turqisë, gjeneral Jashar Gyler. Gjeneral Jashari dhe homologu i tij diskutuan rreth bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve me fokus në planet bilaterale duke përfshirë programet e shkollimit, stërvitjet e përbashkëta dhe hulumtimin e fushave të veçanta të bashkëpunimit.



'Paniku' për miell

PRISHTINË, 4 MARS - Hamdi Jupolli, 62-vjeçar nga Prishtina, para disa ditësh siguroi 100 kilogramë miell në një nga fabrikat e miellit në qytetin e Podujevës. Ai nuk ishte i vetmi. "Në mulli ka pasur kolona të gjata të veturave që kanë pritur që të furnizohen me miell. Frikësohem edhe nga lufta, por edhe për shkak të mundësisë së mungesës së këtij produkti në treg dhe rritjes së çmimit", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Blerja dhe krijimi i rezervave të produkteve ushqimore është një dukuri që po manifeston frikën dhe panikun e krijuar te disa qytetarë të Kosovës pas nisjes së pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Mielli duket se është produkti më i kërkuar. Vitinat e disa dyqaneve ku shitet ky produkt duken të zbrazura.

Jupolli, i cili punon në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, pret që të ketë rritje të çmimit të produkteve për shkak të luftës

midis Rusisë dhe Ukrainës.

Edhe Miradije Ukshini, mbi të 60-tat, e cila jeton me dy fëmijët e saj në një lagje të Prishtinës, thotë se ka blerë miell, vaj dhe sheqer si rezerva për një kohë më të gjatë. "I kam blerë 25 kilogramë miell, 16 euro kanë kushtuar. Nuk e di sa ka qenë më herët për shkak se vazhdimisht kam blerë vetëm nga 5 kilogramë. I kam rezervuar sepse po frikësohem nga lufta. E kemi përjetuar një herë dhe situata atje [në Ukrainë] ka ngjallur frikë. Edhe çmimi po thonë se do të rritet", thotë Ukshini.

Ndërkaq Hazbija, me profesion kontabiliste, po pret që ta marrë pagën për këtë muaj, në mënyrë që të mund të blejë gjëra ushqimore që t'i ketë si rezerva. "Po shpresoj që të dal të blej dy thasë miell, vaj... disa gjëra të tjera i kam siguruar. Po, do të ketë rritje të çmimeve, por edhe lufta... po frikësohem shumë

sepse Kosova nuk është anëtare e NATO-s", thekson ajo.

Për kërkesën e madhe për miell në dy ditët e fundit flasin edhe nga fabrika e miellit "Grunori" në Skenderaj, por edhe qytetarët nga Dragashi.

Musa Gashi, pronar i fabrikës "Grunori", në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë", tha se aktualisht situata është më e qetë dhe nuk ka kërkesa të mëdha. Ai shton se fabrika e tij ka miell të mjaftueshëm për qytetarët e rajonit të Skenderajt deri në fushatën e korres së grurit në muajin korrik. "Jemi duke bashkëpunuar me furrat e bukës që atyre t'u sigurojmë miell në mënyrë që mos të krijohet ndonjë panik i panevojshëm te qytetarët", thotë Gashi.

Kryetari i Shoqatës së Mullisëve të Kosovës, Bashkim Zejnullahu, konsideron se nuk ka nevojë për panik pasi, sipas tij, Kosova nuk është e varur nga Ukraina sa i

përket këtij produkti.

Zejnullahu është pronar i fabrikës së miellit "Thesari" në komunën e Klllokotit. Sipas tij, 100 kilogramë miell shitet për 44 euro dhe aktualisht nuk ka ndonjë ngritje të çmimeve. "Kjo është vetëm një eufori e qytetarëve që duhet të sigurohet mielli", thekson ai. Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vitin e kaluar 68 000 hektarë tokë kanë qenë të mbjellë me kulturën e grurit. Me këtë sasi, sipas kësaj ministrie, Kosova mund të plotësojë 65 përqind të nevojave të popullatës me ushqim.

Pjesa tjetër importohet nga shtetet e ndryshme të rajonit dhe Bashkimi Evropian. Vetëm për dy vjet, nga shtete të ndryshme të rajonit dhe Evropës, Kosova ka importuar miell dhe grurë në vlerë mbi 63.5 milionë euro. Serbia, Hungaria, Kroacia dhe

Austria janë vendet që kanë importuar sasi më të mëdha të grurit dhe miellit vitin e kaluar në Kosovë.

Gjatë vitit 2020 Kosova ka importuar nga Ukraina miell dhe grurë në vlerë prej 28 mijë eurosh, konfirmuan nga Dogana e Kosovës, ndërkaq për vitin 2021 nuk ka të dhëna për importe nga Ukraina.

Ukraina llogaritet të jetë një prej eksportuesve më të mëdha të miellit në botë.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka theksuar se "shoqatat e mullisëve dhe kultivuesit e grurit e kanë siguruar qeverinë" që ka furnizime dhe se "për tre muaj deri në gjashtë muaj popullata jonë nuk ka nevojë të brengoset". Ajo shtoi se në rast nevojë, Kosova ka kanale jashtë vendit dhe mund të sigurojë rezerva shtesë.



Ministri Peci nënshkruan programin e pagesave direkte - subvencione për vitin 2022

PRISHTINË, 4 MARS - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci ka nënshkruar të premtën programin për pagesa direkte - subvencione për vitin 2022, përmes të cilit do të ketë rritje të përkrahjes financiare për shumicën e kulturave bujqësore që mbështeten përmes këtij programi.

Ministri Peci ka treguar se përmes politikave bujqësore në kuadër të këtij programi, kanë ndërmarrë hapa konkretë për t'ua lehtësuar fermerëve veprimtaritë bujqësore

në përballje me vështirësitë e krijuara nga zhvillimet e krijuara së fundi nga rritja e çmimeve të inputeve bujqësore, farërave dhe naftës.

"Sot nënshkrova Programin për Pagesa Direkte për vitin 2022, përmes të cilit kemi adresuar politika të duhura bujqësore. Në kuadër të këtij programi, rritjes së çmimeve të inputeve bujqësore i jemi kundërpërgjigjur me rritje enorme të përkrahjes për bujqit tanë. Përkrahja do të jetë substanciale për shumicën e produkteve e posaçërisht për

produktet strategjike për siguri kombëtare siç janë drithërat, respektivisht gruri, mandej perimet, kulturat pemëtare e të tjera", ka treguar ai.

Gjatë javës së ardhshme ai ka treguar se do të shpalojë në detaje të gjitha masat mbështetëse në kuadër të Programit dhe Pakon gjithëpërfshirëse të veprimeve qeveritare në mbështetje të sektorit të bujqësisë.

Ndërkaq, Programi për Zhvillim Rural për vitin 2022 / Grante, do të aprovohet pas dy jave.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjenerata e artë e përkrah Ademin edhe për një mandat

PRISHTINË, 4 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur në takim gjeneratën e artë të futbollistëve të Kosovës të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë për futbollin, sidomos në periudhën e ish-Jugosllavisë. Ish-futbollistët të cilët kanë lënë gjurmë me punën dhe përkushtimin e tyre në fushën e gjelbër dhe jo vetëm e falënderuan Ademin për, siç kanë thënë, transformimin që ka bërë në futbollin e Kosovës, duke ndikuar në zhvillimin e shpejtë të sportit më masiv në vend, me krijimin e kampeve me kushte tejet komode, e ku përfaqësueset e Kosovës do të mund ta zhvillojnë aktivitetin e tyre. Ajet Shosholli e përgëzoi

Ademin për punën e mirë dhe për respektin që ia bën kësaj gjenerate. Ai shtoi se duke e pasur mundësinë të jenë afër futbollit, e shohin formën e duhur dhe të drejtë me të cilën po zhvillohet futbollit i Kosovës. Ndërsa kapiteni i tyre i parë, Ramadan Cimili, foli mirë për udhëheqjen e shtëpisë së futbollit në krye me Ademin, të cilin e falënderoi për respektin që ua bënë duke u kështilluar me ta dhe duke ua mundësuar të jenë afër futbollit dhe të kenë përgjegjësi pavarësisht prej moshës së shtyrë. Erdogan Celina në fjalimin e tij është shprehur i lumtur që ka qenë pjesë e gjeneratës së artë, por që edhe këto ditë vazhdon të jetë pjesë e futbollit i cili po zhvillohet



shpejt dhe drejt falë udhëheqjes së mirë nga kryetari Ademi. Edmond Rugova e falënderoi

kryetarin Ademi për respektin që ka treguar për gjeneratën e artë ndër vite, duke thënë se është i vetmi që asnjëherë nuk

i la të ndihen të neglizhuar. Ndërsa Abdyl Bellopoja u shpreh i lumtur që Ademi është i gatshëm të vazhdojë edhe për një mandat në krye të FFK-së, duke e konsideruar si personin më të përshtatshëm për ta drejtuar shtëpinë e futbollit. Ndërsa Muharrem Sahiti dënoi ashpër shpifjet që disa persona po i bëjnë me qëllim të njollosjes së imazhit të Ademit, duke pohuar se të njëjtit flasin pavend dhe pa prova. Ai, po ashtu, ka thënë se puna e pastër e kryetarit Ademi vërtetohet edhe me marrëdhëniet që ai ka krijuar me drejtuesit e FIFA-s dhe UEFA-s, Gianni Infantino dhe Aleksandër Çeferin. Ata njëzëri i ofruan mbështetje Ademit në mandatin e ardhshëm dhe i uruan shumë suksese.

Takime interesante në elitën e basketbollit

PRISHTINË, 4 MARS - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 21-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Ndashja e parë do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Dritës. Skuadra prizrenase ka tetë fitore dhe 12 humbje, kurse gjilanasit kanë 20 humbje në 20 ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme në elitë pa fitore. Takim më interesant pritet në mes të Sigal Prishtinës dhe Prizrenit 16. Prishtinasit kanë 10 dhjetë fitore dhe dhjetë humbje, kurse prizrenasit kanë 12 fitore e gjashtë humbje. Sfida pritet me interes, duke marrë parasysh ambicjet e dy skuadrave që synojnë të renditen sa më lart në tabelë. Përballja e fundit zhvillohet



në mes të Rahovecit dhe Trepçës, dy skuadra që kanë pozita të ndryshme në Superligë. Vreshtarët kanë gjashtë fitore e 13 humbje, duke u renditur në vendin e shtatë në elitë, apo të

parafundit, kurse mitrovicasit kanë 14 fitore e gjashtë humbje, duke u renditur në vendin e dytë në tabelë. Rezultati i ndeshjes Peja-Golden Eagle Ylli regjistrohet nga Liga Unike.

Favoritët presin fitore

Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 17 në Superligën e Femrave. Sfida e parë do të zhvillohet në mes të Trepçës dhe Prishtinës, që është edhe përballja më interesante për këtë javë. Mitrovicasit kanë pesë fitore dhe 11 humbje, kurse vashat prishtinase kanë 16 fitore në po aq ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme pa humbje në elitën e femrave. Takimi tjetër i ditës së shtunë është në mes të Vëllaznimit dhe Penzës. Skuadra kuqezi ka katër fitore dhe 12 humbje, ndërsa e kundërta është me skuadrën pejane që ka 12 fitore dhe katër humbje. Takimi i fundit zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe

Kastriotit. Skuadra prizrenase shihet favorite pasi ka 11 fitore dhe pesë humbje, ndërsa vashat ferizajase kanë 16 humbje, në po aq takime.

ART MOTION SUPERLIGA - JAVA 21

Të shtunën takohen:
20:00 Bashkimi - Drita

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Prizreni 16
19:00 Rahoveci - Trepça
Peja - Golden Eagle Ylli (LIGA UNIKE)

SUPERLIGA E FEMRAVE - JAVA 17

Të shtunën takohen:
13:00 Trepça - Prishtina
14:00 Vëllaznimi - Penza

Të dielën takohen:
18:00 Bashkimi - Kastrioti

Kosova dhe Turqia trashin miqësinë në fushën e sportit dhe të rinisë

PRISHTINË, 4 MARS - Kosova dhe Turqia do ta thellojnë bashkëpunimin në fushën e sportit dhe të rinisë. Këto dy shtete kanë nënshkruar marrëveshje ndërshtetërore në kuadër të vizitës zyrtare të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani Sadriu në Turqi. Në emër të Qeverisë së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, marrëveshjen e ka nënshkruar zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla Schwarz. Disa nga pikat që përfshihen në këtë marrëveshje janë: bashkëpunimi për

ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e sportit, shkëmbimi i përvojave në sport dhe rini, organizimi i garave të përbashkëta, realizimi i programeve të shkëmbimit të ekspertëve, shkëmbimi i ekspertëve në fushën e mjekësisë sportive dhe antidopingut, organizimi i kampeve të përbashkëta sportive, forcimi i politikave kombëtare rinore, mbështetja e programeve për punësim dhe formim profesional të të rinjve, zbatimi i programeve dhe projekteve për parandalimin e varësisë, organizimi i kampeve të përbashkëta rinore dhe festivaleve rinore dhe të tjera.



Numri një tenis, Ashleigh Barty: Ende nuk jam gati

Indian Wells, 4 mars - Tenistja australiane Ashleigh Barty, numri 1 në botë, ka konfirmuar se nuk do të luajë në turneun masters të Indian Wells. Ajo ka thënë se ende nuk e ka marrë veten nga lodhja e pësuar gjatë

Australian Open, ku triumfoi para tifozëve të vet, duke u bërë tenistja e parë australiane që fiton grand slam-in e shtëpisë. "Për fat të keq, trupi im nuk ka ende rikuperuar ashtu si duhet pas Australian Open, ndaj nuk

jam përgatitur ashtu si duhet për këtë turne dhe për atë të Majemit që nis më pas. Nuk dua të luaj dhe të humbas, ndaj mendoj se është më mirë të mos marr pjesë dhe të rikuperohem 100 %", ka thënë Barty. "Më vjen keq për

këtë vendim, pasi i adhuroj këto turne. Gjithsesi, të kujdesem për trupin tim është më e rëndësishme", ka deklaruar Barty, që ka qëllim të rikuperohet për turnetë e fushave me dhe që nisin në prill në Evropë.



Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova, 'Laureatët e Vitit 2021'

PRISHTINË, 4 MARS - Xhudistët Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova kanë fituar çmimet kryesore në ceremoninë e Laureatëve të Vitit 2021. Kampionia olimpikë, Krasniqi, u shpall "Sportistja e Vitit", ndërsa kampioni i Evropës, Gjakova, "Sportisti i Vitit". Krasniqit çmimin ia dha presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ndërsa Gjakovës, sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti dhe nënpresidenti Milaim Kelmendi. "Shpresoj që një vit si 2021 të përsëritet. I uroj të gjithë sportistët për një vit pa lëndime dhe që t'i arrijnë synimet e veta", ka thënë Krasniqi.

I lumtur me çmimin u shpreh edhe Gjakova. "Është hera e tretë që fitoj këtë çmim dhe padyshim se jam i lumtur. Shpresoj që bashkë me trajnerin tim t'i arrijmë synimet e mia", ka shtuar ai.

Në fjalën e tij, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, e quajti 2021-n vitin më të suksesshëm në histori të sportit të Kosovës. "Sot jemi mbledhur këtu për t'i kremtuar arritjet në sportin tonë gjatë vitit që kemi lënë pas, arritje këto të cilave do t'ua kishin lakmi shumë shtete të tjera të fuqishme. Kulmi i sukseseve ishin Lojërat Olimpikë Tokio 2020, dhe vetëm të dytat për vendin tonë. Me vetëm 11 sportistë, prej tyre vetëm gjashtë me norme olimpikë, ekipi ynë fitoi dy medalje olimpikë, të dyja të arta dhe të dyja nga sporti ynë më i suksesshëm, xhudo", ka thënë i pari i KOK-ut, duke përmendur edhe sukseset e sporteve të tjera.

Zëvendësministrja për Kulturë, Rini e Sport, Daulina Osmani, vlerësoi lart të arriturat e sportit të Kosovës, me theks të veçantë medaljet e arta olimpikë të fituara në "Tokio 2020". I pranishëm ishte edhe presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Fidel Ylli, i cili në fjalën e tij tha se me suksesin e kampioneve olimpikë u krenua gjithë populli shqiptar. Përmes një videomesazhi ceremoninë e përshëndeti edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës, Spyros Capralos, i cili



vlerësoi lart të arriturat e KOK-ut, duke thënë se mbështetja e bërë për sportistët ka rezultuar edhe me sukseset në Lojërat Olimpikë. Sa iu përket çmimeve tjera, trajnerit Driton Kuka i takoi për herë të gjashtë radhazi çmimi "Trajneri i Vitit". "Viti më i suksesshëm i sportit shqiptar, sportit të Kosovës. Është kënaqësi që KOK-u e ka përkrahur xhudon në vazhdimësi", ka deklaruar Kuka, i cili sukseset ia dedikoi vëllait të tij, kryetarit të Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka.

Me çmimin për "Merita të Veçanta" për kontributin e dhënë gjatë karrierës së saj u nderua kampionia olimpikë Rio 2016, Majlinda Kelmendi. "Çmimin Special" për femra e mori kampionia olimpikë xhudistja

Nora Gjakova, ndërsa për meshkuj ky çmim shkoi për futbollistin Amir Rrahmani. Hendbollit i takoi çmimi për "Kombëtares e Vitit" te meshkujt, ndërsa Kombëtares U-17 i takoi për femrat. "Shpresa Olimpikë" për meshkuj u zgjodh atleti Muhamet Ramadani, kurse për femra xhudistja Erza Muminoviq. Në fund të ceremonisë kompania turistike "Globus" nderoi sportistët e vitit me dy shpërblime "Voucher". Të pranishëm, krahas përfaqësuesve të federatave sportive, ishin edhe sportistë, ish-sportistë eminentë, ambasadorë të shteteve të huaja, përfaqësues të komunave, sponsorë të KOK-ut, të cilët patën rastin të japin çmime bashkë me anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut dhe mysafirë të tjerë.

LAUREATËT 2021

Distria Krasniqi – Sportistja e Vitit
Akil Gjakova – Sportisti i Vitit
Driton Kuka – Trajneri i Vitit
Hendbolli – Kombëtarja e Vitit (M)
Futbolli U-17 – Kombëtarja e Vitit (F)
Nora Gjakova – Çmimi Special (F)
Amir Rrahmani – Çmimi Special (M)
Muhamet Ramadani – Shpresa Olimpikë (M)
Erza Muminoviq – Shpresa Olimpikë (F)
Majlinda Kelmendi – Çmimi për "Merita të Veçanta"

SHKURT

Ndryshohet orari për ndeshjen Spanjë - Shqipëri

Sfida miqësore midis Kombëtares së Shqipërisë dhe Spanjës, e cila do të luhet në Katalunja më 26 mars 2022, nuk do të luhet në orarin që ishte vendosur në fillim. Sfida ishte programuar të luhej në orën 19:00 por, pas disa konsultimeve të Federatës Spanjolle me FShF-në dhe UEFA-n, miqësorja është vendosur të shtyhet për 45 minuta (19:45). Pas Spanjës, Shqipëria do të presë në "Air Albania" Gjeorgjinë, më 29 mars 2022, në kuadër të përgatitjes për Ligën e Kombeve që nis në muajin qershor.

West Hami, gati të paguajë 25 milionë funte për Brojën

West Ham Unitedi mund të paguajë 25 milionë funte për sulmuesin shqiptar të Chelseas, huazuar te Southamptoni, Armando Broja. Sipas 'Sport', West Ham Unitedi është i interesuar ta ketë në skuadër yllin shqiptar. Forma e mirë që është duke kaluar Broja ka ndikuar që të jenë nën vëzhgimin e disa klubeve të mëdha angleze. Përpos Arsenalit, edhe West Hami tani do të provojë ta kompletojë transferimin e Brojës dhe ta bindë Chelsean të paguajë 25 milionë funte. 20-vjeçari është duke mahnitur të gjithë. Në 27 paraqitje ka gjetur rrjetën nëntë herë dhe ka dhuruar një asistim. Në javët e fundit është raportuar që Chelsea do ta shesë Brojën, por jo nën çmimin e 50 milionë funteve.

Salahu për 'Topin e Artë': Isha i tronditur nga renditja

Mohamed Salah është rikthyer të flasë për ceremoninë e çmimit të "Topit të Artë". Ylli i Liverpool u rendit në vendin e shtatë në listën për ta fituar trofeun personal, ku sulmuesi i PSG-së, Lionel Messi, e rrëmbeu këtë çmim si lojtari më i mirë në botë, i cili koleksionoi për herë të shtatë "Topin e Artë". Salah u konsiderua si një favorit i mundshëm për ta marrë çmimin, por në fund ishte larg në renditje dhe, sipas "Daily Mirror", egjiptiani tani e pranon se besonte në një renditje më të lartë në listë. "Më tronditi. Askush në botë nuk priste që unë të isha i shtati, por kështu ndodhi. Nuk e di se mbi çfarë u bazua zgjedhja e tyre, por nuk besoj në asnjë teori konspirative. Nuk e kam ndjenjën se ka ndonjë gjë personale kundër meje. Kështu duket realiteti", ka përfunduar Salah, i cili ka shënuar 27 gola dhe dhjetë asistime në 32 paraqitje në këtë sezon.

E ardhmja e Haalandit varet nga 'Topi i Artë'

Erling Haaland është në pozicionin komod për të qenë në gjendje ta zgjedhë lëvizjen e tij të ardhshme. Ylli i Borussia Dortmundit kërkohet nga Manchester City, Real Madridi

dhe pothuajse të gjithë të tjerët, me Barcelonën e treta në garën për nënshkrimin e tij këtë verë që vjen. Katalanasit do të bëjnë gjithçka që mundën për ta bindur 21-vjeçarin që të vijë në "Camp

Nou" dhe ata janë të interesuar ta shmangin arritjen e Haalandit dhe Kylian Mbappe në Real Madrid. Haalandi dëshiron të jetë pjesë e historisë së futbollit dhe ai beson se lëvizja e tij e radhës

duhet të jetë në një klub që do ta lejojë atë të konkurrojë siç duhet për "Topin e Artë". Është bërë një obsesion i tij dhe këtë ia ka bërë të qartë Mino Raiola, agjentit të tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:165 /1
Dt:03.03.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

RI-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendër e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkollë	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike me 10 orë mësimore.	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
 - Letërnjoftimi (fotokopje);
 - Certifikata për trajnimet e kryera;
 - Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
 - Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
 - Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
- Afati i konkurrimit është 3 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë.
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
 - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
 - Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Rina Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Abdul Frasher" Prizren.

► Florim Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vërmicë.

► Abit Shatri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Bajram Curri" Romajë.

► Blerand Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SHFMU "Yll Morina" nga klasa e -I- deri -V-, dhe -VI-IX-, Gjakovë.

► Liridona Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SHFMU "Ukshin Miftari", Skivjan nga klasa nga klasa e -I- deri -V-, dhe -VI-IX-.

► Musë Gjini shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -III- dhe -IV- si dhe diplomën e QAMO "Hysni Zajmi" drejtimi - Ndërtimtari, Gjakovë.

► Musë Gjini shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I-, dhe -II- të Gjinnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

